



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1268 Prot.

Tiranë, më 23 / 08 / 2019

V E N D I M

Nr. 110, Datë 23 / 08 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32/1/c¹, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenin 41/1/2² të Kodit të Procedurave Administrative, me Urdhërin Nr. 116, datë 15.06.2019 filloi kryesisht procedurën administrative për trajtimin e çështjes në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale.

Në përfundim të procedurës administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve -

Disa organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë në fokus të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të personave me aftësi të kufizuara, informojnë Komisionerin se, kushtet e vendosura në nenin 35/2 të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin kërkohet që personi që bëhet i paaftë për punë për të përfituar pension invaliditeti duhet të ketë qenë i siguruar sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror, i kanë privuar mundësinë personave me aftësi të kufizuara për të qenë përfitues të pensionit të invaliditetit.

Organizatat shprehen se individët që nuk i plotësojnë kushtet e mësipërme, nuk përfitojnë nga asnjë nga skemat e mbrojtjes sociale duke e lënë këtë kategori personash me aftësi të kufizuara pa asnjë mbrojtje.

¹ Neni 32/1/c, Ligji 10221/2010: “Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”

² Neni 41, pikat 1 e 2, Kodi i Procedurave Administrative: “1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik”.

II. Ndjekja e procedurës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Fillimi i procedurës administrative i’u komunikua Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror, me shkresën nr. 1010/1, datë 04.07.2019. Me anë të kësaj shkrese, palëve të përfshira iu kërkuar informacion dhe dokumentacion provues në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Informacion mbi numrin e aplikantëve të cilëve i’u është refuzuar pensioni i invaliditetit nga KMCAP-ja për shkak të mospërmbushjes së kriterit ligjor të parashikuar në nenin 35/2 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që nga momenti i ndryshimeve sipas ligjit nr. 104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, dhe i strukturuar sipas viteve.
- Informacion mbi skemën/skemat e mbrojtjes sociale në kuadër të të cilës/cilave përfiton dhe gëzon mbrojtje kategoria e personave të cilët edhe pse përmbushin kriterin mjekësor për të përfituar pensionin e invaliditetit, i’u refuzohet ky pension për shkak të ndryshimit që i është bërë në vitin 2014, nenit 35/2 të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ju lutem të referoni bazën ligjore të funksionimit të skemës/skemave.
- Nëse është/janë në funksion një skemë/skema, sipas pikës 2 më sipër, ju lutem jepni informacion mbi numrin e personave që kanë përfituar nga kjo/këto skemë/skema. Informacioni të jepet që prej ndryshimeve të vitit 2014 dhe i strukturuar sipas viteve.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën nr. 4886/1, datë 16.07.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, vendosi në dispozicion të Komisionerit, informacionin për numrin e aplikantëve që nuk kanë përfituar invaliditet gjatë periudhës 2015-2019 sipas tabelës më poshtë.

Nr.	Rajoni	2015	2016	2017	2018	2019	Nr. Total
1	Berat	42	92	58	61	34	287
2	Dibër	5	11	21	49	23	109
3	Durrës	41	65	77	54	35	272
4	Elbasan	38	108	65	117	278	606
5	Fier	178	99	68	98	51	494
6	Gjirokastrë	18	38	37	30	18	141
7	Korçë	26	100	190	205	83	604
8	Kukës	1	1	1	1	8	12
9	Lezhë	85	107	177	122	33	524
10	Shkodër	69	88	120	105	108	490
11	Tiranë	93	145	147	117	181	683
12	Vlorë	57	58	45	70	32	262
	Totali	653	912	1006	1029	884	4484

Me shkresën nr. 3569/1, datë 22.07.2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, se ka ngarkuar për dhënien e informacionit të kërkuar, Shërbimin Social Shtetëror.

Me shkresën nr. 1302/1, datë 02.08.2019, Shërbimi Social Shtetëror ka informuar Komisionerin se: “Në mbledhjen e Kuvendit të Shqipërisë në datën 18.07.2019 është miratuar Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale Në Republikën e Shqipërisë”, i cili zgjidh problemin e përfshirjes në skemën e mbrojtjes sociale të personave të cilët janë të pasiguruar, 12 muaj në 5 vitet e fundit”.

Referuar Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 113, datë 01 gusht 2019, faqe 8499, rezulton se në nenin 8/b të këtij ligji është përcaktuar se : **“Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.**

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata e personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk përfitonin nga skemat e mbrojtjes sociale, për shkak të parashikimeve ligjore të nenit 35 të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të sigurimit të trajtimit me pagesë të personave me aftësi të kufizuara të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 90, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur kryesisht me Urdhrin nr. 116, datë 25.06.2019, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

ROBERT GAJDA

KOMISIONER